

Sektori financiar dhe social**Njësia organizative e shërbimeve sociale, rinisë, arsimit dhe muzeut**

Prot. n. 75695 i datës 07/10/2021

NJOFTIM PUBLIK PËR CAKTIMIN E KONTRIBUTEVE EKONOMIKE PËR TË MBËSHTETUR SHPENZIMET PËR SHËRBIMIN E MENSËS SHKOLLORE PËR VËSHTIRËSITË E PAGESËS QË KANË LIDHJE ME COVID-19-ën.**DREJTORI**

Duke pasur parasysh vendimin e këshillit komunal n. 299 të datës 05/10/2021 që përmban “Caktimin e kontributeve ekonomike për të mbështetur shpenzimin e shërbimit të mensës shkollore, për vështirësitë e pagesës që kanë në lidhje me covid-19-ën, miratimin e kriterëve të dhënies, njoftimin publik dhe formularin për kërkesën”.

LAJMËRON

Se është e mundur të paraqitet kërkesa për caktimin e një kontributi ekonomik, për të mbështetur shpenzimet për shërbimin e mensës shkollore, për vështirësitë e pagesës që kanë lidhje me covid-19-ën.

KËRKESA duhet të paraqitet ekskluzivisht duke përdorur procedurën on-line e cila arrihet nga linku i pranishëm në internet, në faqen institucionale www.comune.jesolo.ve.it, te faqja kryesore dhe/ose në hapësirën tematike "Scuole e Nidi", (Shkolla e Çerdhe) te "Sportello Famiglia" (Sporteli Familia) dhe "Sociale e Salute" (Sociale dhe Shëndet) - “<https://cittadino-jesolo.welfaregov.it/clesius/isee/#/accesso>”.

KUSHTET PËR PRANIMIN E KËRKESAVE

Pranohen kërkesat për kontribut nga personat që, në datën e paraqitjes së kërkesës, plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) kanë nënshtetësinë italiane, të një vendi të BE-së, ose në rastin e shtetasve që kanë nënshtetësinë e BE-së, duhet të kenë një lejeqëndrimi të rregullt, ose të kenë dëftesën që vërteton paraqitjen e kërkesës për rinovimin e dokumentit të skaduar.
- b) kërkuesi dhe i mituri duhet të jenë të dy, rezidentë në komunën e Jesolo-s dhe të jenë pjesëtarë të njëjtës bërthamë anagrafike (me bërthamë anagrafike nënkuptojmë bërthamën familjare të regjistruar në regjistrin e gjendjes civile të komunës së Jesolo-s).
- c) duhet të jetë gjetur në periudhën nga data 01/03/2020, deri në datën e paraqitjes së kërkesës, për shkak të emergjencës nga COVID-19, në një situatë të vështirë ekonomike dhe sociale e cila vërtetohet nga të paktën një nga kushtet e mëposhtme:
 - ✓ HUMBJE E VENDIT TË PUNËS/PUSHIM NGA PUNA;
 - ✓ NDRYSHIME KONTRAKTUALE ME ZVOGËLIMIN E ORËVE TË PUNËS;
 - ✓ MUNGESË DHE/OSE VONESË PËR NËNSHKRIMIN E KONTRATËS SË PUNËS SEZONALE;
 - ✓ MUNGESË RINOVIMI TË KONTRATËS;
 - ✓ PAPANËSI, ME PAGESË NGA SIGURIMET SHOQËRORE;
 - ✓ BËRTHAMË ANAGRAFIKE NË TË CILËN NJË ANËTAR KA VDEKUR PËR SHKAK TË COVID-19-ës DUKE SJELLË SI PASOJË ZVOGËLIMIN E TË ARDHURAVE.
- d) Të ketë certifikatën Isee për të MITURIT, të vlefshme e pa asnjë mungesë/mospërputhje, me vlerë të barabartë ose më të vogël se 20.000,00 € në lidhje me bërthamën familjare ku ndodhet i mituri që ka shfrytëzuar mensën e shkollës gjatë viteve shkollore 2019/2020- 2020/2021 për cilën paraqitet një saldo (bilanc) negative;

- e) bërthama anagrafike duhet të ketë një vlerë të pasurisë së luajtshme të barabartë ose më të vogël se 7.500,00 € në lidhje me muajin përpara datës së dorëzimit të kërkesës. Me pasuri të luajtshme nënkuptohen depozitat dhe llogaritë rrjedhëse, letrat me vlerë dhe titujt ekuivalent, obligacionet, certifikatat e depozitave dhe të kreditit, bonot fitimprurëse dhe të ngjashme, pasuri të tjera të luajtshme (të dhëna si shembull por jo në mënyrë shteruese).
- f) prindi kërkues të rezultojë me saldo negative, për shërbimet e mensës së shkollës të komunës së Jesolo-s, për çdo fëmijë në vitet shkollore 2019/2020-2020/2021, për një shumë jo më pak se 50,00 €.

KRITERET E PËRJASHTIMIT

Përfshihen ata që:

- nuk paraqesin kërkesat për pranim;
- kanë paraqitur një kërkesë për më shumë se një anëtar të së njëjtës bërthamë familjare (secila bërthamë familjare mund të paraqesë vetëm një kërkesë për të mitur);
- bilancin (saldo) negativ për secilin të mitur e kanë të barabartë ose më të vogël se 50,00 €.

Shërbimi social do të kryejë një verifikim formal të kërkesës në fazën e marrjes së saj. Do të kontrollohen: dokumenti i identitetit, rezidenca në komunën e Jesolo-s, leja e qëndrimit, prania e kërkesave të paraqitura nga disa anëtarë të të njëjtës bërthamë familjare të regjistruar në gjendjen civile. Në rast anomalish kërkesa do të refuzohet dhe do t'u jepet komunikimi.

MODALITETI I PËRCAKTIMIT TË SHUMËS SË KONTRIBUTIT EKONOMIK

Kontributet ekonomike do të jepen vetëm një herë (una tantum).

Kjo Administratë Komunale do t'i komunikojë çdo familjeje që ka të drejtë, shumën e kontributit ekonomik që është i destinuar të mbështesë shpenzimin për shërbimin e mensës së shkollës, së viteve shkollore 2019/2020 - 2020/2021, që do të jepet nëpërmjet arkëtimit të drejtpërdrejtë në arkat komunale nëpërmjet shërbimit të arkës.

Do të procedohet me dhënien e ndihmës, derisa burimet financiare të kenë shterur.

KONTROLLET DHE HEQJA E PËRFITIMIT

Komuna e Jesolo-s, në bazë të nenit 71 të DPR 445/2000 dhe modifikimet e integrimet e mëvonshme, dhe duke pasur parasysh "Linjat udhëzuese për zyrat komunale për kontrollin e vetë-certifikimeve/deklaratave zëvendësuese të aktit noterial dhe marrjes së të dhënave zyrtare për lëshimin e certifikatave" të aprovuara me Vendimin e Këshillit Bashkiak n. 50 të datës 05/03/2013, do procedojë me kontrole kampione të kërkesave të paraqitura, pra në të gjitha rastet kur lindin dyshime që janë me baza. Do të kryhen kontrole mbi vërtetësinë e deklaratave zëvendësuese të bëra për pjesëmarrjen në këtë njoftim publik dhe, në qoftë se nga kontrollet e sipërpërmendura mund të zbulohet pavërtetësia e asaj që është deklaruar, kërkuesi do të humbasë përfitimet që eventualisht i janë dhënë në bazë të deklaratës së pavërtetë, në përputhje me nenin 75 të DPR 445/2000. Komuna do të procedojë me rikuperimin e detyrueshëm të shumës së paguar në drejtim të kërkuesit dhe do të procedojë me sinjalizimin tek Autoriteti kompetent. Ju lutemi vini re se vetë-certifikimet jo të vërteta përbëjnë një krim që dënohet në bazë të Kodit Penal dhe të ligjeve speciale në lidhje me këtë çështje (neni 76 DPR 445/2000).

Gjatë kontrolleve, Komuna mund të kërkojë ndihmën e Protokolleve të veçanta të Mirëkuptimit me organet e tjera Institucionale si Roja e Financës (Guardia di Finanza).

AFATET PËR PARAQITJEN E KËRKESËS

Kërkesat duhet të paraqiten ekskluzivisht nëpërmjet faqes së internetit “<https://cittadino-jesolo.welfaregov.it/clesius/isee/#/accesso>” nga data **20/10/2021 deri në orën 23.59 të datës 10/12/2021.**

Përgjegjës për procedurën: Stefania Rossignoli.

PËR INFORMACIONE kontaktoni zyrën e shërbimeve sociale të komunës së Jesolo-s në numrin 0421359179 - 0421359188 nga e hëna deri të premten, nga ora 9.00 deri në orën 13.00 dhe të martën e të enjten nga ora 15.00 deri në orën 17.30 ose nëpërmjet adresës e-mail supporto.misura.mensa@comune.jesolo.ve.it.

Jesolo, 07/10/2021

Drejtuesi i sektorit financiar dhe social
Dokt. Massimo Ambrosin

Dokument informatik i nënshkruar me firmë elektronike në bazë dhe në përputhje me nenet 20 e 21 të d. legjislativ të datës 7/03/2005, n. 82 e me modifikimet e mëvonshme; ai zëvendëson dokumentin në letër dhe firmën e shkruar me dorë.